



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

Procesverbal për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës së prokurimit në lote me objekt “Blerje bojë për sinjalistikë rrugore”

I mbajtur sot në datë 11.10.2024 nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit, për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës në lote, përkatësisht për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje bojë për sinjalistikë rrugore” me fondi limit **12,497,950** (dymbëdhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) pa TVSH.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote **sa herë kjo është e mundur**. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”

Në zbatim të nenit të sipërpërmendur, Njësia e Prokurimit gjykon se kjo kontratë nuk mund të ndahet në lote për arsyet e mëposhtme:

Së pari, kemi të bëjmë me të njëjtën lloj mallrash, pra me natyrë të njëjtë, që në thelb i përkasin të njëjtës kategori vetëm ndryshon mënyra e aplikimit në rrugë.

Së dyti, Autoriteti Kontraktor ushtron një veprimtari të gjerë në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, ku përfshihen një nga objektet kryesore dhe të rëndësishme të veprimtarisë së saj, mirëmbajtjen dhe vendosjen e sinjalistikës rrugore në të gjithë territorin e Bashkisë së Tiranës. Në funksion të kësaj veprimtarie AK-ja kërkon që furnizimet të jenë të mundura në cdo moment kur materialet e sinjalistikës rrugore janë të nevojshme dhe pa vonesa ne furnizimin e tyre, krijimi i marrëdhënies kontraktore me disa operatorë ekonomikë, ku AK-së do ti duhet të presë furnizimin e njërit mall nga njëri operator dhe furnizimin e mallit tjetër nga operatori tjetër, sipas loteve, ofron pasiguri, konfuzion, kosto shtesë, vonesa duke vështirësuar në ushtrimin e detyrave të AK-së apo mosrealizim të punëve sipas objektivave.

Si përfundim, për shkak të arsyeve teknike dhe organizative të përmendura më lart, kjo procedurë për vetë rendësinë dhe specifikat e veçanta që ka realizimi i këtij furnizimi si dhe referuar faktit se kemi të bëjmë me të njëjtën natyrë mallrash gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë, në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik, që do të shoqërohej me mirëorganizimin e operatorit për sigurimin e mallit në kohë sipas kërkesave dhe nevojave të AK-së.

NJËSIA E PROKURIMIT